



# Çfarë po ndodh në Shkollat Publike të qytetit të Nju-Jorkut

Shiko këtë dokument në shqip | عرض هذه الوثيقة باللغة العربية | এই নথিটি বাংলা ভাষায় দেখুন  
查看本文件的简体中文版本 | 查看本文件的繁体中文版本 | Consultez ce document en français | Gade dokiman sa a an Kreyòl ayisyen  
이 문서를 한국어로 보십시오 | Документ на русском языке | Consulte este documento en español  
Переглянути цей документ українською мовою | اس دستاویز کو اردو میں ملاحظہ کریں | Ushbu hujjatni ichida ko'ring O'zbek

[schools.nyc.gov/MessagesForFamilies](https://schools.nyc.gov/MessagesForFamilies)

## Mars 2026

Ky përditësim për familjen ofron informacion të rëndësishëm rreth programit veror "Summer Rising 2026", ofertave për shkollën e mesme për vjeshtën 2026, konferencave prind-mësues, Javës së Edukatës Qytetare dhe Anketës së Shkollave të qytetit të Nju-Jorkut për vitin 2026.

## Përmbajtja

- **Programi veror (Summer Rising) 2026**
- **Ofertat për shkollën e mesme për vjeshtën 2026**
- **Konferenca prind-mësues**
- **Java e Edukatës Qytetare**
- **Anketa e shkollave të qytetit të Nju-Jorkut për vitin 2026**

## Programi veror "Summer Rising" 2026

NYCPS-ja po bashkëpunon sërish me Departamentin e Rinisë dhe Zhvillimit të Komunitetit (Department of Youth and Community Development, DYCD) për të ofruar programin veror "Summer Rising" gjatë vitit 2026. Ky program veror lidh nxënësit e shkollave fillore dhe nëntë-vjeçare me përvoja argëtuese dhe praktike që forcojnë aftësitë e tyre akademike, sociale dhe emocionale. Programi veror ofrohet **falas** dhe është i hapur për të gjithë nxënësit e qytetit të Nju-Jorkut që janë aktualisht në kopsht e deri në klasën e 8-të. Më shumë informacion mbi datat dhe oraret e programit do të publikohet në [schools.nyc.gov/SummerRising](https://schools.nyc.gov/SummerRising) kur të hapen aplikimet më 3 mars.

"Summer Rising" përfshin mësimdhënie akademike të udhëhequra nga NYCPS-ja dhe aktivitete vijuese të zhvilluara nga organizata komunitare (CBO) të DYCD-së. Vaktet e mëngjesit dhe drekës ofrohen falas. Për më shumë informacion, vizitoni [schools.nyc.gov/SummerRising](https://schools.nyc.gov/SummerRising).

### Aplikimi në MySchools për programin veror "Summer Rising"

Aplikimi është i hapur nga data **3 deri më 27 mars 2026**. Për të aplikuar, hyni në llogarinë tuaj [MySchools.nyc](https://MySchools.nyc) nëse keni një të tillë ose krijoni një të re, duke përdorur adresën tuaj të emailit, numrin nëntëshifror të ID-së së nxënësit dhe kodin e krijimit të llogarisë MySchools, të cilin mund ta merrni nga shkolla e fëmijës suaj. Nëse keni

përdorur më parë MySchools për të aplikuar për programe verore ose gjatë vitit shkollor, fëmija juaj mund të jetë shtuar tashmë në llogarinë tuaj. Kini parasysh se MySchools është një llogari e veçantë nga NYCSA-ja.

Nuk ka kufizim në numrin e programeve që familjet mund të shtojnë në aplikim. Shtimi i më shumë programeve rrit mundësinë që të caktoheni në një program sipas zgjedhjes suaj.

Ky proces **nuk** bazohet në parimin "i ofrohet atij që aplikon i pari"; të gjitha aplikimet e dorëzuara brenda afatit trajtohen njësoj, sipas prioriteteve të pranimeve. Mund të bëni ndryshime në aplikimin tuaj në çdo kohë brenda periudhës së aplikimit. Për pyetje të mëtejshme, vizitoni [schools.nyc.gov/SummerRising](https://schools.nyc.gov/SummerRising) ose kontaktoni me shkollën.

## Nxënësit me Programe të Individualizuara të Arsimit (Individualized Education Programs, IEP) dhe Plane 504

Nxënësit që ndjekin klasa speciale 12-mujore/klasën e vitit të zgjatur shkollor, (ESY) Nest ose Horizon do të marrin shërbimet e rekomanduara në IEP-në e tyre në një shkollë programit veror Horizon, Nest, distrikti 75 (D75) ose ESY.

Familjet që dëshirojnë të marrin pjesë në një program 12-mujor të IEP-së (përfshirë ESY, D75, Nest dhe Horizon) dhe në aktivitetet zhvillimore me orar të zgjatur të udhëhequra nga CBO-të përmes programit "Summer Rising", duhet të aplikojnë përmes MySchools. Udhëzime të posaçme do të publikohen në MySchools.

Nëse fëmija juaj do të marrë pjesë vetëm në programin "Nest" ose "Horizon" (deri në orën 12:00), D75 (deri në orën 14:30), ose vetëm në programin ESY (deri në orën 14:00), dhe nuk dëshironi aktivitete me orar të zgjatur, ju lutemi të kontaktoni me shkollën e fëmijës në vend që të aplikoni përmes MySchools.

---

## Ofertat për shkollën e mesme për vjeshtën 2026

Nëse fëmija juaj ka aplikuar për shkollë të mesme për vjeshtën 2026 brenda afatit të datës 3 dhjetor 2025, ofertën e shkollës do ta merrni më 5 mars 2026. Hyni në llogarinë tuaj [MySchools](https://schools.nyc.gov) për të parë ofertën dhe çdo caktim në listëpritjeje (nëse është e aplikueshme), si dhe informacion mbi hapat e mëtejshëm. Për të mësuar se si bëhen ofertat, [schools.nyc.gov/HS](https://schools.nyc.gov/HS).

---

## Takimet mes Prindërve dhe Mësuesve

**Konferencat prind-mësues (PTC)** në mars janë një mundësi e shkëlqyer për të diskutuar zhvillimin e fëmijës suaj dhe mënyrat se si mund ta mbështesni atë në shtëpi, së bashku me mësuesit e tij. Konferencat prind-mësues këtë vit shkollor zhvillohen në distancë, por mund të ofrohen edhe personalisht. Shërbimet e përkthimit me gojë dhe shkrim janë gjithashtu të disponueshme sipas kërkesës. Datat e konferencave prind-mësues mund të ndryshojnë sipas shkollës; mësuesit e fëmijës suaj do t'ju ndihmojnë të lini një takim. Për më shumë udhëzime, vizitoni [schools.nyc.gov/ptc](https://schools.nyc.gov/ptc).

- **E enjte, 5 mars:** Konferenca prind-mësues pasdite dhe në mbrëmje për shkollat fillore dhe qendrat parashkollore (Pre-K Centers)
- **E enjte, 12 mars:** Konferenca prind-mësues pasdite dhe në mbrëmje për nxënësit e arsimit të mesëm të ulët dhe shkollat D75
- **E mërkurë, 18 mars:** Konferenca prind-mësues në mbrëmje për shkollat e mesme, K-12 dhe 6-12
- **E enjte, 19 mars:** Konferenca prind-mësues pasdite për shkollat e mesme, K-12 dhe 6-12

## Java e Edukatës Qytetare

Nga data 9–13 mars, bashkohuni me ne në [Javën e Edukimit Qytetar](#) ku do të ketë aktivitete që festojnë zërin e të rinjve, fuqizimin qytetar dhe regjistrimin e votuesve. Mësoni më shumë dhe shikoni serinë tonë të komikëve “Civics for All” në: [schools.nyc.gov/CivicsForAll](https://schools.nyc.gov/CivicsForAll).

---

## Anketa e shkollave të qytetit të Nju-Jorkut për vitin 2026

Plotësoni **anketën vjetore të shkollave të NYC** deri më **1 prill 2026!** Familjet e NYCPS-së dhe nxënësit e klasave 6–12 mund të japin sugjerimet lidhur me përvojat e tyre në shkollat tona, gjë që na ndihmon të përmirësojmë mjedisin e të nxënësve, kurrikulat, shërbimet mbështetëse e më shumë. Dërgoni anketën tuaj sot me postë ose online, në një nga 13 gjuhët e disponueshme, në [NYCSchoolSurvey.org](https://NYCSchoolSurvey.org) ose hyni në llogarinë tuaj shkollore të qytetit të Nju-Jorkut ([NYCSA](#)) në [SchoolsAccount.nyc](https://SchoolsAccount.nyc).